



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1106/6 prot.

Datë 23.05.2024

V E N D I M
Nr.561/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.05.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00345-04-05-2024, me objekt “Blerje Mjeti per zhvillimin e kanaleve Ujitese (Eskavator)” me fond limit 7,327,692.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Ankimues: Operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK me NIPT L82523203F dhe adresë: Lagjja “Luigj Gurakuqi”, Bulevardi “Aqif Pasha”, Hotel Skampa, kati 5 nr. 303, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Pogradec me adresë: Lagjja nr. 2, bulevardi "Reshit Çollaku", Pogradec.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.04.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00345-04-05-2024, me objekt “Blerje Mjeti per zhvillimin e kanaleve Ujitese (Eskavator)”, me fond limit 7,327,692.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

II.2. Në datën 18.04.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton, se në datën 22.04.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat pa TVSH si më poshtë:

- “ARTEO 2018” SHPK,	7 198 500	Lekë	skualifikuar
-“CompiTel” SHPK,	7 227 000	Lekë	skualifikuar
- “TEKNOXGROUP SHQIPERI” SHPK,	7 250 000	Lekë	kualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK rezulton i skualifikuar për arsye se:

Nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST. Konkretisht:

- Nuk permbush piken 2.3.2 te DT “Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë per llojin e mjetit te ofruar”, pasi autorizimi i paraqitur nuk eshte origjinal por fotokopje. OE ka paraqitur vertetim perkthimi dhe jo vertetim noterizimi (Njehsim me origjinalin) nga noteri.

- Nuk permbush piken 2.3.3 te DT “Operatori ekonomik duhet të paraqese për mjetin që oferton, llojin e tij (marka, modeli, viti i prodhimit, numri i identifikimit të tij) të shoqëruar me foto nga të gjitha anët dhe me dokumentacionin përkatës (katalog/skedë teknike/librezë/leje qarkullimi), në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK”, pasi nga ana e OE nuk eshte paraqitur asnje dokument identifikues i mjetit (katalog/skede teknike/ libreze/ leje qarkullimi), qe te deshmoje origjinalitetin e tij, lidhjen e tij me prodhuesin. Ne permbushje te kesaj pike, OE ka paraqitur nje dokument te fotokopjuar, te pa njehsuar me origjinalin, te shoqeruar me vertetim perkthimi dhe qe nuk deshmon asnje lidhje me prodhuesin, nga i cili eshte marre autorizimi i prodhuesit.

- Ne specifikimet teknike te paraqitura, mungon viti i prodhimit per mjetin e ofertuar, si dhe nuk permbushen specifikimet teknike, sipas kerkesave te AK. Per sa me siper, oferta e operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK është e pavlefshme.

II.4. Në datën 30.04.2024 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.5. Në datën 04.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4052 dhe me nr. 1106/2024 prot., datë 07.05.2024, e operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00345-04-05-2024, me objekt “Blerje Mjeti për zhvillimin e kanaleve Ujitëse (Eskavator)” me fond limit 7,327,692.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec, ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht në ankesë operatori ekonomik ankimes pretendon: *“Referuar skualifikimit tone nuk jemi dakort pasi Autorizimi i prodhuesit i paraqitur nga ana jone eshte plotesisht konform kerkeses se DST, pasi i gjithe dokumentacioni Autorizimit eshte fotokopje i shoqeruar me vule te njome lidhese nga noteri. Persa i perket pikes 2.3.3 te DST , ne si operator ekonomike ARTEO 2018 shpk ju kemi paraqitur skeden teknike te shoqeruar me foto te ndryshme te mjetit te kerkuara nga ana juaj. Ne lidhje me lejen e qarkullimit te kerkuar nga ana juaj, kjo eshte nje lapsus nga AK pasi mjete i kerkuar objekt ne kete faze prokurimi (nga fabrika prodhuese) nuk shoqerohet me leje qarkullimi ,pasi kjo tregon per nje indicje te paracaktuar te fituesit te tenderit. Persa i perket vitit te prodhimit mjete qe do te disponohet nga ana jone si OE do te prodhohet ne mementin qe ne shpallemi fitues te procedures se prokurimit ne respektim te afateve kohore dhe specifikimeve teknike te kerkuara nga ana juaj si AK. Gjithashtu ne si operator ekonomik kemi paraqitur oferten me te vlefshme ekonomike. Vlersojme te merrni parasysht sqarimet tona dhe te na kualifikoni si operatori ekonomik me oferten ekonomike me te vlefshme dhe specifikimet teknike te sakta te kerkuara nga ana juaj.”*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1106/2 prot., datë 07.05.2024.

II.7. Në datën 13.05.2015 autoriteti kontraktor ka ngakuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes e cila u protokollua me tonën me nr. 1106/3 prot., datë 13.05.2015 nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes me argumentin“[...]Referuar Ankesës së OE “ARTEO 2018” shpk, me pretendimet si më poshtë:

- *Referuar skualifikimit tone nuk jemi dakord pasi Autorizimi i prodhuesit i paraqitur nga ana jone eshte plotesisht Konform kerkeses se DST, pasi i gjithe dokumentacioni i Autorizimit eshte fotokopje i shoqeruar me vule te njome lidhese nga noteri. Lidhur me Pikën i të skualifikimit: Nga Operatori ekonomik “ARTEO 2018” shpk, me Nipt L82523203F, nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, siç kërkohen në DST.*

Konkretisht:

- 1- *Nuk permbush piken 2.3.2 te DT “Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë per llojin e mjetit te ofruar”, pasi autorizimi i paraqitur nuk eshte origjinal por fotokopje. OE ka paraqitur vertetim perkthimi dhe jo vertetim noterizimi (Njehsim me origjinalin) nga noteri.*

OE ankimues pretendon se për këtë kriter ka dorëzuar dokumentacion të saktë konform DST.

*KSHA, pasi merr në shqyrtim Autorizimin e Prodhuesit të paraqitur nga OE ankimues, konstaton se OE ka paraqitur autorizimin Fotokopje ne gjuhen angleze, me pas e ka perkthyer, dhe e ka shoqeruar me Vertetim Perkthimi, nga perkthyes i licencuar dhe me pas e ka vertetuar perkthimin prane nje zyre noteriale. Pra ne te gjithë kete process, dhe me dokumentet qe ka bashkengjitur, OE verteton qe dokumentin e ka perkthyer, nuk verteton Njehsimin e autorizimit te prodhuesit me origjinalin. Sa me siper KSHA mban te njejtin qendrim, duke konsideruar te pasakte Autorizimin e Prodhuesit, duke mos qene dokument origjinal ose i njehsuar me origjinalin. Kjo gje, kuptohet edhe nga Vertetimi i Perkthimit, ne te cilin citohet se: **“Perkthyesi me deklaroi se perktheu me perpikmeri dhe saktesi DOKUMENTIN bashkengjitur nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe dhe e nenshkroi rregullisht perpara meje Noterit.”** Pra, noteri shprehet se ka perkthyer me saktesi dokumentin, dhe jo ORIGINALIN, sic do te ishte shprehur nese do ti ishte vene ne dispozicion kopja origjinale per tu perkthyer, sipas Ligjit per Noterine. Akoma me tej, KSHA pasi verifikon autorizimin, konstaton se website i deklaruar ne autorizimin e prodhuesit nuk rezulton qe te jete i aksesueshem (bashkengjitur Screenshot sipas te dhenave te deklaruar).*

Për rrjedhojë pretendimi i OE ankimues “ARTEO 2018” shpk nuk qëndron.

2- Lidhur me Pikën II të skualifikimit:

Konkretisht:

- Nuk permbush piken 2.3.3 te DT “Operatori ekonomik duhet të paraqese për mjetin që oferton, llojin e tij (marka, modeli, viti i prodhimit, numri i identifikimit të tij) të shoqëruar me foto nga të gjitha anët dhe me dokumentacionin përkatës (katalog/skedë teknike/librezë/leje qarkullimi), në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specififikimet teknike të kërkuara nga AK”, pasi nga ana e OE nuk eshte paraqitur asnje dokument identifikues i mjetit (katalog/skede teknike/ libreze/ leje qarkullimi), qe te deshmoje origjinalitetin e tij, lidhjen e tij me prodhuesin. Ne permbushje te kesaj pike, OE ka paraqitur nje dokument te fotokopjuar, te panjehsuar me origjinalin, te shoqeruar me vertetim perkthimi dhe qe nuk deshmon asnje lidhje me prodhuesin, nga i cili eshte marre autorizimi i prodhuesit.

- OE ankimues pretendon se për këtë kriter ka dorëzuar skeden teknike te shoqeruar me foto te mjetit ashtu si jane kerkuar ne DT.

- Ne lidhje me lejen e qarkullimit te kerkuar , eshte bere lapsus nga AK pasi mjeti i kerkuar ne kete faze prokurimi (nga fabrika prodhuese) nuk shoqerohet me leje qarkullimi.

KSHA, pasi merr në shqyrtim kete pike skualifikimi, konstaton se operatori ne permbushje te kesaj pike ka dorezuar nje document, ne te cilin jane pasqyruar disa specifikime teknike, i cili nuk eshte i njehsuar me origjinalin por thjesht nje document i perkthyer dhe i shoqeruar me Vertetim Perkthimi. Per me teper, dokumenti nuk provon qe te jete leshuar nga Prodhuesi, nga i cili operatori ka marre Autorizimin e Prodhuesit. Pra nuk provohet te kete lidhje midis

prodhuesit dhe dokumentit ne te cilin pasqyrohen specifikimet teknike te mjetit. Nga AK, ne permbushje te kesaj pike jane kerkuar dokumentacionin përkatës (katalog/skedë teknike/librezë/leje qarkullimi), në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara. Pra, AK thjesht kerkon nje dokument identifikimi te mjetit, kjo per te verifikuar pajtueshmerine e specifikimeve teknike. Pra edhe nje dokument i thjeshte, i leshuar nga prodhuesi, i cili verteton pajtueshmerine e specifikimeve teknike, do te quhej i vlefshem. Por, nga ana e operatorit ankimues, ne kete rast, dokumenti nuk eshte leshuar nga prodhuesi, as nga distributor i autorizuar nga prodhuesi, dhe nuk verteton origjinalitetin e mjetit per te cilin ka ofertuar.

Për rrjedhje pretendimi i OE ankimues “ARTEO 2018” shpk nuk qëndron.

- Lidhur me Pikën III të skualifikimit: Ne specifikimet teknike te paraqitura, mungon viti i prodhimit per mjetin e ofertuar, si dhe nuk permbushen specifikimet teknike, sipas kerkesave te AK.

OE pretendon se mjete qe do te disponohet nga ana e tij do te prodhohet ne momentin qe shpallen fitues te procedures se prokurimit. KSHA, pasi merr në shqyrtim kete pike skualifikimi verifikon specifikimet teknike te kerkuara dhe ato te paraqitura nga ana e Operatorit Ekonomik ankimues dhe konstaton se ka mosperputhje midis specifikimeve te kerkuara dhe atyre te deklaruar nga OE, si me poshte:

- Nuk ka deklaruar Vit Prodhimi*
- Nuk ka deklaruar mbi gjatesine nga aksi ne aks*
- Ngarkesa maksimale ne piken e permbysjes me e vogel (3000 kg) se marzhi I parashikuar 6400 – 6500 kg*
- Ngarkesen maksimale ne lartesine maksimale me e vogel (3000 kg) se ajo e parashikuar 3300 kg – 3400 kg*
- Nuk ka specifikuar thellesine e germimit kova para.*
- Nuk ka deklaruar kapacitetet e rimbushjes*
- Nuk ka deklaruar klasifikimin e akseve*
- Nuk ka deklaruar permbushjen e Standardit EN474*
- Nuk ka deklaruar mbytyjen e zhurmave sipas standardit EU 102 DB.*

Pra, ne thelb, rezulton se specifikimet e deklaruar nuk jane sipas specifikimeve te kerkuara ne DT.

Duke pasur parasysh edhe faktin qe oe ne momentin e ofertimit duhet te kete te qarte mjetin per te cilin oferton, duhet te kishte deklaruar mbi permbushjen e te gjitha specifikimeve per mjetin qe oferton.

OE nuk mund te shprehet se mjete do te prodhohet ne momentin e shpalljes fitues, pasi nuk mund te flase per nje mjet qe nuk ekziston, qe do te prodhohet ne te ardhmen, me kusht qe te shpallet fitues.

Për rrjedhje pretendimi i OE ankimues “ARTEO 2018” shpk nuk qëndron.

KSHA shprehet se, Kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Sipas nenit 77, pika 5 e LPP: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Neni 92, pika 3 e LPP, thote se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme”.

Gjithashtu ne Ligj thuhet se: “Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedure prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”

Neni 75 pika 1 e LPP: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave”.

Referuar sa më sipër, vlen të theksojmë se, në rast se operatori ekonomik ankimes do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor për sa i përket dokumenteve të tenderit, publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit object shqyrtimi, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave.

Rrjedhimisht, përderisa OE ankimes nuk ka paraqitur as kërkesë për sqarim dhe as ankesë në lidhje me këto kritere apo espec teknike, atëherë ai ka qenë i detyruar që për tu kualifikuar të paraqiste dokumentacionin e plotë siç është kërkuar në DST.

Per sa me siper, KSHA vendos:

- 1. Të mos pranoje ankesën e operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK në procedurën e prokurimit “Blerje Mjeti per zhvillimin e kanaleve Ujitese (Eskavator)”, me Nr. REF-00345-05- 05-2022, me fond limit 7 327 692 (Shtate milion e treqind e njezet e shtate*

mijë e gjashtëqind e nentëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec, si të pa mbështetur në Ligj dhe në Regullat e Prokurimit Publik.”

II.8. Nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Arteo 2018” SHPK: *“Nuk permbush piken 2.3.2 te DT “Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë per llojin e mjetit te ofruar”, pasi autorizimi i paraqitur nuk eshte origjinal por fotokopje. OE ka paraqitur vertetim perkthimi dhe jo vertetim noterizimi (Njehsim me origjinalin) nga noteri.”* KPP-ja vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.2, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë per llojin e mjetit te ofruar.

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

III.1.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, në përmbushje të këtij kriteri operatorit ekonomik ankimues ka dorëzuar;

- Letër autorizimi e prodhuesit JINING SAAO MACHINERY MANUFACTURING CO., LTD bashkëngjitur të cilit ndodhen specifikimet teknike të cilat nuk vërtetohet nëse janë të prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi të shoqëruara me vërtetim përkthimi datë 17.04.2024 me NR RE.P 2018, ku nga noteri thuhet se: *“Përkthyesi më deklaroi se përktheu me*

përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkëngjitur nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.”

III.1.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikon se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.1.4. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.1.5. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.6. Në nenin 129, pika 5, “Vërtetimi i njësisë me origjinalin” të ligjit 110/2018 “Për Noterinë” parashikohet shprehimisht se : “1. Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, të dokumenteve të publikuara, si dhe të çdo dokumenti tjetër, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre.

2. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin.

3. Kur dokumenti i paraqitur ka shënime, korrigjime, shtesa, fshirje ose shenja të tjera të veçanta, noteri bën njësimin dhe i pasqyron ato në vërtetim. Në vërtetim pasqyrohet edhe nëse dokumenti origjinal është grisur, dëmtuar apo në ndonjë formë tjetër duket i dyshimtë në pamjen e tij, përveç kur kjo duket qartë nga kopja e dokumentit origjinal.

4. Në rastin e kopjeve të shkurtuara, noteri sqaron nëse pjesët e hequra kanë ndonjë lidhje për pjesët e paraqitura të aktit.

5. Në rastin kur dokumenti është në gjuhë të huaj noteri bën vërtetimin e njësisë me origjinalin, duke kërkuar ndihmën e një përkthyesi, ose duke e bërë vetë kryesisht, sipas parashikimeve të nenit 100 të këtij ligji”.

III.1.7. Ndërsa në nenin 135 “Vërtetimi i përkthimeve” të ligjit 110/2018 “Për Noterinë” parashikohet shprehimisht se: “1. Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, të dokumenteve të publikuara, si dhe të çdo dokumenti tjetër, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre. 2. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin. 3. Kur dokumenti i paraqitur ka shënime, korrigjime, shtesa, fshirje ose shenja të tjera të veçanta, noteri bën njësimin dhe i pasqyron ato në vërtetim. Në vërtetim pasqyrohet edhe nëse dokumenti origjinal është grisur, dëmtuar apo në ndonjë formë tjetër duket i dyshimtë në pamjen e tij, përveç kur kjo duket qartë nga kopja e dokumentit origjinal. 4. Në rastin e kopjeve të shkurtuara, noteri sqaron nëse pjesët e hequra kanë ndonjë lidhje për pjesët e paraqitura të aktit. 5. Në rastin kur dokumenti është në gjuhë të huaj noteri bën vërtetimin e njësisë me origjinalin, duke kërkuar ndihmën e një përkthyesi, ose duke e bërë vetë kryesisht, sipas parashikimeve të nenit 100 të këtij ligji.

III.1.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i

shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP-ja konstaton, se në përmbushje të kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentet më sipër. Në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi është percaktuar shprehimisht që: *“Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”* Duke ballafaquar përmbajtjen e dokumenteve të tenderit me ligjin sektorial në fuqi konkretisht ligjin nr. 110/2018 “Për Noterinë” specifikisht me nenin 129 pika 1 dhe 2 në të cilin parashikohet se: *“1. Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, të dokumenteve të publikuara, si dhe të çdo dokumenti tjetër, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre. 2. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin.”* mungon vërtetimi i njësimimit me origjinalin i dokumentit të autorizimit të prodhuesit, i cili ashtu sikurse edhe vetë ankimuesi e pranon në sistem, është i ngarkuar fotokopje. Është detyrë e operatorëve ekonomikë të paraqesin dokumentet origjinale ose kopje të noterizuara sipas procedurës së sipërcituar të percaktuar nga ligji nr. 110/2018 “Për Noterinë”. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin duke gjykuar, se ligji nr. 110/2018 “Për Noterinë” noterizimin e një dokumenti fotokopje si në rastin konkret, e materializon përmes aktit të vërtetimit të njësimimit me origjinalin të dokumenteve, të cilat paraqiten fotokopje dhe jo me vulën e noterit të vendosur në mes dokumenteve të lidhra me njëri-tjetrin, bazuar kjo edhe në pretendimit të ankimuesit se *“Autorizimi i prodhuesit i paraqitur nga ana jone eshte plotesisht konform kerkeses se DST, pasi i gjithë dokumentacioni Autorizimit eshte fotokopje i shoqeruar me vule te njome lidhese nga noteri”*. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e percaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka percaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar një dokument i cili është ngarkuar fotokopje dhe i panoterizuar ashtu siç kërkohet në dokumentet e tenderit dhe siç ligji sektorial konkretisht ligji nr. 110/2018 “Për Noterinë” parashikon.

III.1.10. Gjithashtu, sqarojmë, që në rast se operatori ekonomik ankimues “Arteo 2018” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave bazuar në nenin 75, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se *“1. Ofertuesi i mundshëm*

mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.”

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Arteo 2018” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Arteo 2018” SHPK: *“Nuk permbush piken 2.3.3 të DT “Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mjetin që oferton, llojin e tij (marka, modeli, viti i prodhimit, numri i identifikimit të tij) të shoqëruar me foto nga të gjitha anët dhe me dokumentacionin përkatës (katalog/skedë teknike/librezë/leje qarkullimi), në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK”, pasi nga ana e OE nuk është paraqitur asnjë dokument identifikues i mjetit (katalog/skede teknike/ libreze/ leje qarkullimi), që të deshmohet origjinalitetin e tij, lidhjen e tij me prodhuesin. Në permbushje të kësaj pike, OE ka paraqitur një dokument të fotokopjuar, të pa njehsuar me origjinalin, të shoqëruar me vertetim përktimi dhe që nuk deshmon asnjë lidhje me prodhuesin, nga i cili është marrë autorizimi i prodhuesit.”* KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.3 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

“2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mjetin që oferton, llojin e tij (marka, modeli, viti i prodhimit, numri i identifikimit të tij) të shoqëruar me foto nga të gjitha anët dhe me dokumentacionin përkatës (katalog/skedë teknike/librezë/leje qarkullimi), në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.”

III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar;

- Foto të mjetit në pjesën ballore, anësore, mbrapa dhe pjesën e brendshme të tij.

- specifikime teknike të cilat nuk vërtetohet nëse janë të prodhuesit të shoqëruara me vërtetim përktimi datë 17.04.2024 me NR RE.P 2018 ku nga noteri thuhet se: *“Përkthyesi më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkëngjitur nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.”*

III.2.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikon se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë*

pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.2.4. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.2.5. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.2.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i

parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.2.7. Referuar rastit konkret KPP konstaton, se në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi. Nisur nga pretendimet e ankimuesit dhe nga kthim - përgjigjja e autoritetit kontraktor, KPP vëren se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fotot e kërkuara në secilin prej pozicioneve, anësore, ballore, foto nga mbrapa dhe në mjediset e brendshme të mjetit, por nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar nga autoriteti kontraktor në mënyrë alternative si *(katalog/skedë teknike/librezë/leje qarkullimi)*, pasi dokumenti i paraqitur si specifikime teknike në sistem nga ankimuesi i shoqëruar me vërtetim përkthimi datë 17.04.2024 me NR RE.P 2018, nuk vërteton në asnjë moment që është i lëshuar nga prodhuesi me qëllim që mbi bazën e të dhënave të këtij dokumenti të mund të verifikohej përputhshmëria e përmbajtjes së tij me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij, referuar kjo dhe pretendimit të ankimuesit, i cili alternativën e paraqitjes së lejes së qarkullimit e konsideron si: *“nje lapsus nga AK pasi mjeti i kerkuar objekt ne kete faze prokurimi (nga fabrika prodhuese) nuk shoqerohet me leje qarkullimi ,pasi kjo tregon per nje indicje te paracaktuar te fituesit te tenderit.”*, duke rikujtuar se operatorët ekonomikë në përputhje me parashikimet e *lex specialis* janë të detyruar të përgatisin oferta në përputhje me kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Nëse do të kishte pretendime mbi kërkesat për kualifikim, operatori ekonomik ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës për dokumentet e tenderit ose nëse do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave bazuar në nenin 75, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit është përmbushur pjesërisht kërkesa më sipër, duke e përmbushur atë vetëm në lidhje me fotot e mjetit të paraqitura në sistem por jo me dokumentet e kërkuara në mënyrë alternative nga autoriteti kontraktor si *(katalog/skedë teknike/librezë/leje qarkullimi)*

Sa më lart pretendimet e ankimuesit “Arteo 2018” SHPK qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Arteo 2018” SHPK: “Ne specifikimet teknike te paraqitura, mungon viti i prodhimit per mjetin e ofertuar, si dhe nuk permbushen specifikimet teknike, sipas kerkesave te AK. Per sa me siper, oferta e operatorit ekonomik “ARTEO 2018”, shpk është e pavlefshme.” KPP vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 5 “formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Skicimet, parametrat teknik etj:

SPECIFIKIME TEKNIKE:

<i>Nr</i>	<i>Pershkrim i mallit</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi</i>	<i>Vlera</i>
	<i>Mjet per zhvillimin e kanaleve Ujtese (Eskavator)</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>		
	<i>Shuma pa TVSH</i>				
	<i>T.V.SH 20%</i>				
	<i>Shuma me TVSH</i>				

SPECIFIKIME TE MJETIT QE KERKOHET TE BLIHET:

Karakteristikat teknike te makinerise

Mjeti te jete me 0 Km

Vitit i Prodhimit: 2022 - 2024

Fuqia e vleresuar e motorrit SAE J1995: 80-100 Kuaj Fuqi

Cilindrata/Vellimi 4.2 - 4.8 Liter

Vleresimi pa renie fuqie te motorrit nga 2200 deri ne 2300 metra lartesi

Karburanti – Nafte

Sistemi Hidraulik/pompa me zhvendosje te ndryshueshme me piston aksial, ne 2100 - 2300 rrotullime/min: 90 - 160L/Min

Presioni i sistemit:

-Perpara : 200 - 250 Bar

-Krahu mbrapa: 200 - 250 Bar

- Dimensionet:

- Gjatesia nga aksi ne aks: 2100 - 2200 mm*
- Ngarkesa maksimale deri ne piken e permbysjes: 6400 - 6500 Kg*
- Ngarkesa maksimale ne lartesine maksimale: 3300 - 3400Kg*

- *Kendi i shkarkimit ne lartesine maksimale : 45 Grade*
- *Thellesia e germimit kova para: 120 – 140 mm*
- *Thellesia e germimit kova pas: 5600 – 5800 mm*
- *Arritja nga vija qendrore e boshtit te pasme në vije tokesore: 7500 – 7700 mm*

- Kapacitetet e rimbushjes:

<i>Transmesioni (AWD)</i>	<i>18 -20 L</i>
<i>Vaj Motorrit</i>	<i>8 - 10 L</i>
<i>Depozita karburantit:</i>	<i>140 - 180 L</i>
<i>Vaji Hidraulik(depozita):</i>	<i>40 - 50 L</i>
<i>Vaji Hidraulik(sistemi):</i>	<i>70 - 100 L</i>

- Klasifikimi i akseve(Boshteve)

- I perparme

<i>Statike:</i>	<i>23000 - 24000 kg</i>
<i>Dinamike:</i>	<i>8000 - 10000 kg</i>

- I pasme

<i>Statike:</i>	<i>26000 - 28000 kg</i>
<i>Dinamike:</i>	<i>9000 - 10000 kg</i>

- ❖ *Krahu i pasem ne forme harku/parakrahu i drejte teleskopik(me zgjatje)*
- ❖ *Ajer i kondicionuar*
- ❖ *Kova perpara shume perdorimshe me dhembe, kove qe hapet, me dhembe piruni, 1 – 1.1 m3*
- ❖ *Kova pasme per pune te renda, 600 – 650 mm ose te tjera (ose sipas kerkeses), me pershtates me dhembe me kellef qe nderrohen, e perforcuar me material shtese per te rezistuar.*
- ❖ *4 marshe perpara, 4 marshe per mbrapa*
- ❖ *Dritat e punes(8 cope), Portotarge me drite, sedilja materiali standart*
- ❖ *Kontroll navigimi (per te absorbuar lekundjet gjate levizjes me pesha)*
- ❖ *Gomat te nje marke te njohur me dimesnionet 12-16/80(te perparmet)-18/16.9-28(Te pasmet)*
- ❖ *Te katerta gomate aktive, te perparmet komanduese*
- ❖ *Parafango perpara dhe ajo mbrapa me zgjatues*
- ❖ *Kunderpeshe 100 - 120 kg, mbrojtese nga poshte per transmesionin per terrene shkembore, stabilizantet me shtrese gome per pozicionim per terrene me asfalt.*
- ❖ *Pergatitur sipas standartit, EN474.*
- ❖ *Mbytja e zhurmave, EU, 102 DB*
- ❖ *Kotrolli me leva mekanike*
- ❖ *Ftohes per vajin e hidraulikut*
- ❖ *Garancia Standarte 1 vit*

III.3.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

-Specifikime teknike të shoqeruara me vertetim përkthim datë 17.04.2024 dhe NR.REP 2018

III.3.3. III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.4. Referuar nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.3.5. Neni 77 "Kërkesat për kualifikim", pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.3.6. Në nenin 40 pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.3.7. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që

produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.3.8. Referuar rastit konkret, KPP konstaton, se në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.3.2 të këtij vendimi. Nisur nga pretendimet e ankimuesit dhe nga kthim - përgjigjja e autoritetit kontraktor, KPP vëren, se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistem një dokument si specifikime teknike, i shoqëruar me vërtetim përkthimi, datë 17.04.2024, me NR. REP 2018 që përveçse nuk vërteton në asnjë moment që është i lëshuar nga prodhuesi, me qëllim që mbi bazën e të dhënave të këtij dokumenti të mund të verifikohet përputhshmëria e përmbajtjes së tij me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, por edhe në përmbajtjen e tij siç është ngarkuar në sistem, mungon specifikimi teknik në lidhje me vitin e prodhimit. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij referuar kjo dhe pretendimit të ankimuesit mbi vitin e prodhimit, i cili shprehet se: *“Per sa i perket vitit te prodhimit mjeti qe do te disponohet nga ana jone si OE, do te prodhohet ne mementin qe ne shpallemi fitues te procedures se prokurimit ne respektim te afateve kohore dhe specifikimeve teknike te kerkuara nga ana juaj si AK.”*, duke rikujtuar, se operatorët ekonomikë në përputhje me parashikimet e *lex specialis* janë të detyruar të përgatisin oferta në përputhje me kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, të cilat duhet të jenë të ngarkuara në sistem në momentin e hapjes së ofertave, në mënyrë që edhe Komisioni i Vlerësimi të Ofertave të mund të vlerësojë mbi bazën e tyre, nëse një ofertë e paraqitur është e vlefshme apo jo. Nëse do të kishte pretendime mbi kërkesat për kualifikim, operatori ekonomik ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës për dokumentet e tenderit ose nëse do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave, bazuar në nenin 75, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Sa më lart, operatori ekonomik përveçse ka paraqitur një dokument si specifikime teknike në sistem, i shoqëruar me vërtetim përkthimi datë 17.04.2024, me NR REP 2018, që nuk vërteton në asnjë moment që është i lëshuar nga prodhuesi, këtij dokumenti i mungon edhe viti i prodhimit si specifikim teknik, duke mos përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Ndërsa lidhur me arsyen e skualifikimit “*si dhe nuk permbushen specifikimet teknike, sipas kerkesave te AK.*”, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Arteo 2018” SHPK dhe skualifikimin e tij, nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke e skualifikuar për këtë arsye në mënyrë abuzive dhe të paargumentuar, pa përcaktuar se cilën nga specifikimet teknike të përcaktuara në DST e tjera të procedurës të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, nuk përmbush oferta e paraqitur prej tij. Gjykojmë, se ashtu sikurse është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me përmbushjen e kritereve, si dhe të specifikimeve teknike të kërkuara, edhe autoriteti kontraktor (komisioni i vlerësimit të ofertave) ka barrën e provës të vërtetojë dhe argumentojë, se cilin nga specifikimet teknike të tjera, nuk përmbush oferta e tij, duke mirëargumentuar edhe mosplotësimin e tyre. Bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, barra e provës në rastin konkret, për vërtetueshmërinë e pretendimit (arsyes së skualifikimit), i takonte komisionit të vlerësimit të ofertave të identifikonte në mënyrë të saktë dhe të qartë, se cilin nga specifikimet e tjera teknike nuk përmbushte oferta e tij, duke dhënë argumentet mbi këtë fakt, i cili në rastin konkret ka dështuar t’i evidentojë dhe t’i argumentojë. Në këtë kuadër KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit, e pasqyruar në raport-audit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: “*si dhe nuk permbushen specifikimet teknike, sipas kerkesave te AK.*”, është abuzive dhe e paargumentuar. Në këtë kuptim, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar së cila nga specifikimet nuk përmbushet nga oferta e paraqitur në sistem nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK, KPP e gjen arsyen e skualifikimit të ankimuesit për këtë fakt të pabazuar. Është detyrë e zyrtarëve përgjegjës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të pasqyrojnë në SPE vlerësimin e tyre, në mënyrë të qartë, konkrete dhe të kuptueshme. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, (shiko Çështjen C-27/15 Pippo Pizzo) ka konkluduar, se shkaqet e skualifikimit duhet të përcaktohen qartësisht dhe të publikohen paraprakisht në kohë të mjaftueshme, me qëllim që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të njihen me këto shkaqe. GJED në vendimin e mësipërm ka konfirmuar, se “përcaktim qartësisht” i shkaqeve të skualifikimit, do të thotë që të garantohet, se ofertuesit janë njohur me kërkesat specifike procedurale dhe që të njëjtat kërkesa, aplikohen njëjloj për të gjithë ofertuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shkeljet e mësipërme, cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së

Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur, se “Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret, parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Sa më lart, pretendimi i ankimuesit për arsyen e skualifikimit “si dhe nuk permbushen specifikimet teknike, sipas kërkesave të AK.” qëndron.

Sa më lart, pretendimi i ankimuesit “Arteo 2018” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik” Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00345-04-05-2024, me objekt “Blerje Mjeti për zhvillimin e kanaleve Ujitese (Eskavator)”, me fond limit 7,327,692.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Arteo 2018” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Florent Zguro

